

**ADEM MEZINI: "SHEKULLI XX",
Shtëpia botuese EXSTRA-R, Tiranë 2011, 349 f.**

Libri më i fundit i shkruar nga prof. dr. Adem Mezini i vjen lexuesit, pas disa shkrimeve dhe botimeve të tjera të suksesshme të viteve të fundit, ku materializohet më së miri përvoja e tij e gjatë si pedagog në fakultete të ndryshme të Universitetit të Tiranës, me mendimin e pjekur, si një studiues i mirëkualifikuar dhe njohës shumë i mirë i historisë moderne evropiane e botërore.

Botimi përfshin një numër ligjëratash të zgjedhura për historinë politike botërore, duke mos lënë jashtë trajtimin edhe Shqipërinë e periudhës totalitare e tranzicionit. Libri fokusohet kryesisht tek zhvillimet politike më të rëndësishme të shekullit XX, por nuk ngelen jashtë trajtimeve edhe ngjarje të mëdha historike të periudhave paraardhëse dhe më të fundit, që i përkasin fillim shekullit XXI.

Të veçantat e këtij botimi dhe përgjithësisht veçorinë e studimeve të prof. Mezinit e përbëjnë analizat teorike të kombinuara me ato faktike - fryt i prirjes personale dhe eksperiencës së tij të gjatë shkencore dhe tematika që ai trajton. Pothuajse në çdo studim të këtij libri do të gjeni të gërshetuar më së miri këta komponentë. Ata janë të pranishëm edhe kur studiohen probleme të mirëfillta teorike, siç janë alternativat historike, por edhe kur trajtohen zhvillime të veçanta të historisë së shteteve evropiane si të Francës, Rusisë, Britanisë së Madhe, Italisë, Gjermanisë etj. Me interes janë gjithashtu edhe shkrimet mbi Shqipërinë e periudhës totalitare - komuniste dhe të periudhës së tranzicionit, ku spikatin sërish analizat dhe vështrimet e kombinuara, të fenomeneve lokale, të cilat janë të integruara brenda një kuadri të gjerë ndërkombëtar. Por autori nuk ka lënë pa trajtuar edhe perspektivat e zhvillimeve të ardhshme politike dhe sfidat që e presin shoqërinë njerëzore në perspektivë. Zhvillimet politike e sociale të Shqipërisë së periudhës së komunizmit dhe të tranzicionit janë trajtuar gjithashtu me kompetencë profesionale dhe larg ndikimeve të politikës së ditës.

Libri "Shekulli XX" përbëhet nga tri pjesë, të titulluara: "Alternativat", "Çështje të historisë së shteteve evropiane" dhe e fundit: "Arritje dhe perspektiva". Në pjesën e parë trajtohet koncepti për alternativat historike dhe tipat e tyre. Në libër janë analizuar dhe sjellë përmes fakteve alternativa liberale, socializmi totalitar sovjetik, revolucionet ruse të viteve 1905 dhe 1917, si dhe alternativa e terrorit dhe e Luftës që i kushtohet nazizmit në Gjermani. Analiza e këtyre teorive është bërë duke u mbështetur tek studiuesit më në zë të këtyre fushave (Zhan Pol Sartri, Erik Hobsbaun, Pol Xhonsen, Zbigniev Brzezinski, Erik Frmm, Antonio Gramshi, Wollter Laker etj.) dhe tek

politikanë të shquar si Lenini, Gorbaçovi, Winston Churchill etj. Autori ka ndërthurur më së miri teorinë me analizën e proceseve historike. Koha tregoi se disa alternativa si totalitarizmi i materializuar tek fashizmi e komunizmi, ndonëse populiste, ishin jetëshkurtra, të panatyrshme, të sforcuara, të dështuara dhe me kosto të lartë për popujt që i provuan ato, por edhe për mbarë botën që i ndjeu direkt apo indirekt efektet e tyre. Këto “eksperimente” të shoqërisë njerëzore u shoqëruan me fenomene negative për jetën e miliona njerëzve dhe popujve që i jetuan ato vite.

Në pjesën e dytë, prof. Mezini analizon kryesisht rolin e socialdemokracisë evropiane gjatë shekullit XX dhe zhvillimet politike më të spikatura në Evropë gjatë këtij shekulli. Mendimi socialdemokrat, në dallim nga socializmi totalitar i qëndroi kohës. Kjo filozofi u materializua më së miri në qeverisjen e partive të majta socialdemokrate e socialiste në Evropë gjatë shekullit të kaluar, por edhe në shekullin e ri. Autori bën një vështrim të thellë të socialdemokracisë dhe filozofisë së saj, që nga gjeneza deri në periudhën bashkëkohore, duke vënë në dukje vlerat dhe dobinë e saj, jo thjesht në aspektin teorik, por sidomos në qeverisjet e socialdemokratëve e të socialistëve në Evropën Perëndimore e Veriore. Në libër i kushtohen faqe të tëra socialdemokracisë gjermane dhe mendimit socialist bashkëkohor në Gjermani, duke vënë në pah gjenezën e tij, por edhe rolin pozitiv të socialdemokracisë gjermane në zhvillimin dhe përparimin e vendit të vet. Me interes janë gjithashtu në këtë botim përsiatjet e autorit për Revolucionin e Tetorit dhe teorinë që e udhëhoqi atë, parë tashmë nga mundësitë që të jep vështrimi nga “lartësitë” e një procesi tashmë të mbyllur. Por jashtë trajtimit nuk mbeten as zhvillimet politike të Rusisë së sotme, me anët pozitive e negative të saj.

Pjesa e tretë e këtij libri, që shënon njëkohësisht edhe mbylljen e tij, merret me rezultatet e zhvillimit shoqëror në shekullin XX dhe me sfidat që e presin shoqërinë në shekullin XXI. Autori ka arritur në disa konkluzione interesante, pasi është lënë pas shekulli XX. Tashmë, bota nuk është më eurocentrike si në shekullin XIX. Tanimë janë shndërruar në fuqi botërore të tjerë shtete, duke filluar nga SHBA, Japonia, Kina etj., pesha e të cilëve është prezente në kohën e sotme. Evropa, si një entitet i veçantë politik e ekonomik po shkon drejt integritit. Liberalizmi, si alternativë tashmë e provuar nuk ka mbetur statike, por ka pësuar ndryshime e korrigjime, duke e krahasuar atë, me variantin e shekullit XIX. Autori ka bërë objekt studimi sistemet dhe regjimet politike të shekullit që lamë pas, ndryshimet e mëdha ekonomike e politike që pësoi bota gjatë shekullit të kaluar, duke iu referuar studiuesve më të njohur të kohës. Duke parandjerë rreziqet dhe sfidat gjatë shekullit që po jetojmë, autori nuk i ka lënë pa trajtuar edhe sfidat që e presin në të ardhmen shoqërinë njerëzore si dhe perspektivat e zhvillimit të saj. Ndër këto të fundit autori ka përfshirë problemin demografik dhe rritjen shpërthyesë të njerëzimit gjatë shekullit XX;

sfidën e sigurimit të burimeve të saj të jetesës; rritjen e diferencave ndërmjet vendeve të pasura dhe të varfra; problemin e papunësisë dhe tendencës së lëvizjes së popullsisë drejt vendeve të pasura; problemet ekologjike dhe raportet e ndryshuara të njeriut me natyrën, duke sjellë për këtë qëllim një sërë faktesh e treguesish.

Si përfundim, mund të themi se, libri i fundit i prof. Mezinit ka vlera të spikatura, jo vetëm për shkak të temës që trajton, e cila rrallë bëhet objekt i studimeve shqiptare, por sidomos për thellësinë e mendimit dhe vështrimin global e botëror të fenomeneve e të zhvillimeve politike, që ndikojnë mbi gjithë njerëzimin. Libri dëshmon gjithashtu për pjekurinë shkencore të autorit, i cili ka kompetencën të trajtojë të tilla tema, të cilat kërkojnë njohuri të gjera teorike e analiza të argumentuara përmes fakteve. Libri, duket se i drejtohet më shumë studiuesit të specializuar se sa publikut të gjerë e të zakonshëm. Pavarësisht nga kjo, ai është një botim serioz dhe i dobishëm për cilindo, që dëshiron të njohë më mirë dhe më thellë zhvillimet politike të shekullit të kaluar dhe sfidat që ka përpara shoqëria gjatë shekullit që kemi hyrë.

Hamit KABA

